

**V E N D I M**  
**CAKTIM MASE SIGURIMI**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga :

**ANTONELA PRENDI - GJYQTARE**

asistuar nga sekretare gjyqesore Azeta Dede, sot ne 29.03.2010 mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore kerkesen penale me Nr. Akti 595 qe i perket :

**K E R K U E S:** Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, perfaqesuar nga prokurori Besnik Cani.

**O B J E K T I:** Venie e sekuestros preventive mbi llogarine bankare ne emer te M.K, dtl 26.05.1980 prane Bankes Popullore.  
Venie e sekuestros preventive mbi llogarine bankare ne emer te N.K, dtl 25.11.1946 prane Bankes Popullore.  
Venien e sekuestros preventive mbi apartamentin me siperfaqe 106 m2 te blere nga shtetasja B.K me vendndodhje ne katin e 7 te banimit ne pallatin qe ka ndertuar shoqeria " Bjorn " sh.p.k , me adrese rr " ..... ", ndertuar me lejen e ndertimit sipas vendimit nr (....) dhe nr (....), dt 04.02.2009 te Bashkise Tirane.  
Venien e sekuestros preventive mbi apartamentin me siperfaqe 99 m2 te blere nga shtetasi N.K me vendndodhje ne katin e trete te banimit ne pallatin e ndertuar nga shoqeria " Belavis " sh.p.k ne (.....)

**BAZA LIGJORE:** Nenet 274,pika 2 e K Pr Penale dhe neni 36/2 I KP.

Gjykata pasi degjoi diskutimet perfundimtare te prokurorit, I cili kerkoi pranimin e kerkeses, deklaroi te mbyllur shqyrtimin gjyqesor dhe si çmoi provat ne teresi

**V E R E N**

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka paraqitur per gjykim prane kesaj gjykate kerkesen penale me objekt : " *çaktimin e mases se sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi llogarite bankare te M.K, N.K dhe apartamentet e blere nga B.K e N.K*".

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi e provuar se :

Prokuroria e Athines ka nisur procedimin penal per vepren penale " Pengmarrje dhe kercenim ne bashkepunim " parashikuar nga nenet 45, 94, 322 dhe 385 te Kodit Penal ne ngarkim te 8 te akuzuarve mes tyre dhe shtetasi M.K.Kjo veper penale ka ndodhur gjate periudhes 19.06.2009 – 25.06.2009.Nga veprimet e para hetimore ka rezultuar se eshte rrembyer shtetasja E.F, banuese ne (.....) dhe eshte kercenuar miku I saj A.TH , I cili u ka dhene pengmarresve pagesen ne cash prej 1 800 000 Euro per te bere te mundur lirimin e shtetases se marre peng. Shtetasi M.K eshte shpallur ne kerkim nderkombetar.

Paralelisht me hetimet qe jane duke u zhvilluar ne shtetin grek Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, mbi bazen e materialit kallezues te ardhur nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit ka rregjistruar procedimin penal nr 659 per vepren penale “ Pastrim I produkteve te vepres penale” parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal. Hetimet kane filluar mbi bazen e informacionit te percjelle ne Drejtorine kunder Krimet Financiar me dt 04.02.2010 nga Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit te Parave, e cila ka raportuar disa raste transaksionesh financiare qe perbejne dyshim per pastrim te produkteve te vepres penale. Nga veprimet hetimore ekzistojne dyshime se sasia e lekeve e fituar nga vepra penale e pengmarrjes ne shtetin grek eshte futur ne qarkullim civile ne RSH nga ana e personave te dyshuar per kryerjen e vepres penale ne formen e hapjes se llogarive bankare dhe blerjes se pasurive te paluajtshme.Prokuroria greke ka derguar prane organit te akuzes ne Shqiperi nje liste me dhenat e numrave te serive te Eurove te perfituara nga personat nen hetim si rezultat I pengmarrjes.

Nje prej personave te akuzuar per kryerjen e vepres penale ne shtetin grek eshte M.K, I biri I (.....), dtl (.....)

Nga informacioni I paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit, te marra ne rruge operative dhe nga sistemi I te dhenave TIMS rezulton se shtetasi M.K pas kryerjes se vepres penale ka hyre ne territorin e RSH.Ndersa bashkeshortja dhe babai I tij, respektivisht B.K e N.K pak kohe pas kryerjes se vepres penale te pengmarrjes kane realizuar blerje te pasurive te paluajtshme ne vlera te konsiderueshme monetare, me para cash, ne kushtet kur keto trasaksione nuk i pergjigjen nivelit te tyre ekonomik, pasi nga te dhenat e disponuara nga QKR nuk rezulton te kene patur ndonjehere aktivite te regjistruara.Konkretisht :

1. **Shtetasja B.K**, bashkeshortja e personit nen hetim M.K sipas te dhenave te certifikates familjare, me dt 28.10.2009 ka lidhur nje kontrate sipermarrije me shoqerine “ Bjorn “ sh.p.k nr 7038 Rep, nr 1630 Kol, per ndertimin e me pas blerjen e nje apartamenti me siperfaqe 106 m2, te ndodhur ne katin e 7 te banimit, ne pozicion F1, e ndare ne 2 plus 1, sipas planimetrise bashkangjitur kontrates.Cmimi I apartamentit eshte paguar teresisht nga porositesja me para cash ne dore ne vleren 137 800 Euro.Shuma ne fjale eshte derdhur ne Banken e Tiranes ne llogari te sipermarresit me dt 28.10.2009 sikurse rezulton nga mandate pagesa e paraqitur si prove ne gjykim. Nga informacioni I percjelle nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit rezulton qe shtetasja B.K gjate transaksiove financiare ne banke ka deklaruar se burimi i te ardhurave eshte puna ne emigracion. Ndertimi I apartamentit ka perfunduar, por nuk eshte rregjistruar ne ZVRPP, pasi eshte perfshire ne procesin e legalizimit,sikurse vertetohet nga teresia e akteve te praktikes administrative
2. **Shtetasi N.K**, I ati I personit nen hetim M.K, me dt 06.07.2009 ka lidhur nje kontrate sipermarrije nr 4756 Rep, nr 600 Kol me shoqerine “ Blavis “ sh.p.k per ndertimin dhe blerjen e nje apartamenti ne (.....), kati I trete I banimit, ana e majte nga perendimi, tip B/2, 2 plus 1, me siperfaqe ndertimi 99 m2, siperfaqe te perbashketa 9,9 m2, siperfaqe totale 108,9 m2, sipas planvendosjes bashkangjitur kontrates.Cmimi I apartamentit eshte paguar teresisht nga porositesi me para cash ne dore ne vleren 70 000 Euro.Nga verifikimet dhe kqyrja ne vend e realizuar nga organi I akuzes rezulton te kete perfunduar ndertimi I apartamentit, I cili eshte ne proces rregjistrimi nga shoqeria ndertuese prane ZVRPP.

Gjithashtu sipas te dhenave te derguara nga Banka Popullore me shkresen nr 1791/1 Prot, dt 11.03.2010 rezulton se personi nen hetim M.K dhe I ati N.Kkane llogari bankare

prane Bankes Popullore, te cilat jane bllokuar nga banka. Sipas informacionit te Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit te marre nga Banka Popullore N.K disa dite pas kryerjes se vepres penale te pengmarrjes ka patur nje patur nje kreditim ne llogarine e tij ne Banken Popullore ne shumen 70 000 Euro me pershkrimin “ te ardhura nga emigracioni “

Nga informacioni i marre nga QKR rezulton se personi nen hetim M.K, bashkeshortja e tij B.K dhe I ati N.K nuk kane patur asnjehere te rregjistruar ndonje veprimtari tregetare.

Mbi bazen e fakteve dhe provave te mesiperme Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane kerkon nga gjykata marjen e mases se sigurimit sekuestro preventive mbi llogarine bankare te personit nen hetim M.K dhe te atit te tij N.K prane Bankes Popullore si dhe apartamenteve te blera nga shtetasja B.K e N.K, duke argumentuar se parate ne llogarite bankare dhe ato qe kane sherbyer per blerjen e pasurive te paluajtshme kane prejardhje nga krimi I pengmarrjes ne shtetin grek dhe vazhdimi I qarkullimit te tyre civil, transformimi dhe zhvendosja e pronesise rendon pasojat e vepres penale te “ Pastrimit te produkteve te vepres penale”.

Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane cmon se ajo eshte e bazuar ne nenin 274 te KPrP dhe si e tille duhet pranuar.

Neni 274 I KPrPenale sanksionon :

*“1. Kur ka rrezik qe disponimi I lire I nje sendi qe lidhet me vepren penale mund te rendoje ose zjase pasojat e saj ose te lehtesoje kryerjen e veprave te tjera penale me kerkese te prokurorit gjykata penale urdheron sekuestrimin e tij me vendimin te arsyetuar.*

*2. Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet, produktet e vepres penale dhe cdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet sipas nenit 36 te Kodit Penal.....*

Sekuestro preventive eshte mase sigurimi me karakter pasuror qe aplikohet ne rastet kur ka arsye te dyshohet se disponimi I lire I nje sendi qe lidhet me vepren penale rendon ose zjat pasojat e saj ose mund te lehtesoje kryerjen e veprave te tjera penale. Vendosja e sekuestros ne kete rast pengon perdorimin e tjetersimin e sendeve qe lidhen me vepren penale ( *produktet e vepres penale, perfitimet, shperblimet, mjetet qe kane sherbyer per kryerjen e vepres penale* )pra pjesemarrjen e tyre ne qarkullimin civil, duke garantuar ne kete menyre nevojat e sigurimit. Sekestrimit vendoset mbi cdo lloj pasurie qe lejohet te konfiskohet ne baze te nenit 36 te Kodit Penal, ne te cilin perfshihen krahas vete produkteve te vepres penale dhe cdo pasuri tjeter qe perben transformim, shnderrim ose bashkim I produktit te vepres penale.( *1.Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka te beje me marrjen dhe kalimin ne favor te shtetit b) te produkteve te vepres penale, ku perfshihet cdo lloj pasurie 2. Nese produktet e vepres penale jane transformuar ose shnderruar pjeserisht ose plotesisht ne pasuri te tjera keto te fundit I nenshtrohen konfiskimit*). Pra masa e sekuestros preventive zbatohet mbi produktet e vepres penale dhe ne rast te tjetersimit te tyre tek persona te trete ose shnderrimit e transformimit te tyre ne pasuri te tjera.

Nga provat e nenshtuara shqyrtimit gjyqesor rezulton se organi I akuzes ka nisur procedimin penale per vepren penale te “ Pastrimit te produkteve te vepres penale” dhe ekzistojne prova te mjaftueshme per te krijuar dyshimin e arsyeshem se kjo veper eshte kryer nga personi nen hetim M.K.

Nga te dhenat e paraqitura nga Prokuroria e Athines rezulton se personi nen hetim M.K dyshohet se ne bashkepunim dhe me disa te pandehur te tjere kane rrembyer nje shtetase greke dhe ne shkembim te lirimit te saj kane perfituar shumen prej 1 800 000 Euro.

Nga hetimet e zhvilluara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane jane mbledhur prova te mjaftueshme qe krijojne dyshimin se vlera monetare e perfituar nga vepra penale e pengmarrjes ne shtetin grek eshte vendosur ne qarkullimin civil ne territorin e shtetit shqiptar

permes hapjes se llogarive bankare dhe blerjes se pasurive te paluajtshme nga personi nen hetim M.K, bashkeshortja dhe I ati I tij.

Keshtu rezulton e provuar se personin nen hetim pas kryerjes se vepres penale ne shtetin grek ka hyre ne territorin e RSH. Disa dite pas kryerjes se vepres penale I ati I personit nen hetim N.K ka kredituar llogarine e tij ne Banken Popullore shumen 70 000 Euro me pershkrimin te ardhura nga emigracioni. Bashkeshortja e personit nen hetim B.K dhe I ati N.K pak kohe pas kryerjes se vepres penale kane blere pasuri te paluajtshme ne vlera te konsiderueshme monetare. Transaksionet financiare per blerje nuk jane kryer permes bankave, por me para ne dore. Burimi I deklaruar ne banke per blerjen e apartamentit nga shtetasja B.K eshte ” e ardhura nga emigracioni “. Personi nen hetim, bashkeshortja dhe I ati nuk rezultojne te kene patur asnjehere aktivitet tregetar.

Provat e siperanalizuara krijojne dyshimin e arsyeshem se vlerat monetare te depozituara prane Bankes Popullore nga personi nen hetim M.K dhe I ati I tij N.K si dhe mjetet monetare te perdoruar per blerjen e apartamenteve jane produkti I vepres penale te pengmarrjes per te cilen po hetohet shtetasi M.K nga Prokuroria e Athines. Ne arrijten e ketij konkluzioni gjykata mori parasysh kohen e realizimit te transaksioneve financiare dhe veprimeve juridike te porositjes e blerjes se pasurive te paluajtshme, e cila perkon pak kohe pas kryerjes se vepres penale te pengmarrjes, deklarimet e burimit te te ardhurave ( nga emigracioni) dhe ne menyre specifike analizoi faktin se niveli ekonomik I personit nen hetim, bashkeshortes dhe te atit te tij nuk justifikon natyren dhe shumen e transaksioneve bankare dhe veprimeve juridike te kryera, ne reference te faktit se personat ne fjale nuk rezultojne te kene ushtruar asnjehere aktivitet ekonomik.

Ne keto kushte gjykata cmon se eshte e nevojshme te zbatohet masa e sigurimit “ sekuestro preventive “ e kerkuar nga organi I akuzes ne baze te nenit 274 te KPrP. **Kjo mase cmohet e nevojshme per te shmanguar qarkullimin e metejshem civil te produktit te vepres penale te pengmarrjes, transformimin e tij, tjetersimin tek te tretet, duke renduar e zjatur ne vijimesi pasojat e vepres penale.**

Ne keto kushte gjykata urdheron vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarite bankare te personit nen hetim M.K e te atit N.K prane Bankes Popullore.

Njekohesisht urdherohet dhe vendosja e sekuestros preventive mbi apartamentet e porositura sipas kontratave respektive te sipermarrjes nga shtetasja B.K e N.K. Per keto apartamente personat ne fjale kane paguar teresisht cmimin sipas kontrates. Pra te ardhurat monetare qe dyshohen te jene produkt i vepres penale te pengmarrjes jane vene ne qarkullim civile dhe jane shnderruar ne pasuri te tjera te paluajtshme. Apartamentet kane perfunduar se ndertuari dhe sendet sot kane nje ekzistence fizike. Mbi bazen e ketij vendimi gjyqesor vendoset sekuestrimi I tyre, per te cilin duhet te njoftohen dhe Zyrrat perkatese Vendore te Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme qe pas perfundimit te procesit administrativ te rregjistrimit te kryejne veprimet perkatese ne ekzekutim te ketij vendimi. Apartamentet jane te identifikuar ne permbajtje te kontratave te sipermarrjes dhe pasqyrohen grafikisht ne planvendosjet bashkangjitur tyre.

Sa me lart parashtroi gjykata vendos pranimin e kerkeses se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane si te bazuar ne ligj dhe ne prova.

## **PER KETO ARSYE**

Mbeshtetur ne nenin 274 te K Pr Penale, gjykata

## **V E N D O S I**

- A)** Pranimin e kerkeses.
- B)** Caktimin e mases se sigurimit sekuestro preventive mbi llogarite bankare te personit nen hetim M.K dhe N.K prane Bankes Popullore.
- C)** Caktimin e mases se sigurimit sekuestro preventive mbi apartamentin e porositur dhe blere nga shtetasja B.K me kontraten e sipermartjes nr 7038 Rep, nr 1630 Kol, dt 28.10.2009 lidhur me shoqerine “ Bjorn “ sh.p.k me siperfaqe 106 m2, te ndodhur ne katin e 7 te banimit, ne pozicion F1, e ndare ne 2 plus 1, sipas planimetrise bashkangjitur kontrates, ndertuar ne baze te lejes se ndertimit nr (...), dt 04.02.2006 te KRRT Bashkia Tirane.
- D)** Caktimin e mases se sigurimit sekuestro preventive mbi apartamentin e porositur dhe blere nga shtetasi N.K me kontraten e sipermartjes nr 4756 Rep, nr 600/1 Kol, dt 06.07.2009 lidhur me shoqerine “ Belavis “ sh.p.k , kati I trete I banimit, ana e majte nga perendimi, tip B/2, 2 plus 1, me siperfaqe ndertimi 99 m2, siperfaqe te perbashketa 9,9 m2, siperfaqe totale 108,9 m2, sipas planimetrise bashkangjitur kontrates, ndertuar ne baze te lejes se ndertimit nr (.....), dt 25.03.2005 te KRRT Bashkia Golem.
- E)** Ngarkohet policia gjyqesore Tirane per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi.
- F)** Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve nga shpallja e vendimit.Per subjektet e interesuara ky afat fillon nga dita e venies ne dijeni te sekuestros.

**U shpall ne Tirane date 29.03.2010**

**S E K R E T A R E**

**G J Y Q T A R E**

**AZETA DEDE**

**ANTONELA PRENDI**